

Festimi Global i Lutjes—2024

Lavdërimi—Perëndia është i Madh: i pari, i shquar mbi të tjerët, dukshëm më i lartë në karakter dhe cilësi; i shquar në madhësi, shkallë, fuqi, forcë, masë.

E jotja, o Zot, është madhështia, fuqia, lavdia, shkëlqimi, madhëria, sepse gjithshka që është në qiell dhe mbi tokë është jotja. E jotja o Zot është mbretëria, dhe ti ngrihesh sovran mbi gjithshka. 1 Kronikave 29:11 ALB

O Zot Zot, ti ke filluar t'i tregosh shërbëtorit tënd madhësinë tënde dhe dorën e fuqishme që ke; sepse cila është perëndia në qiell apo në tokë që mund të kryejë vepra dhe mrekulli si ato që bën ti?

Ligji i Përtërirë 3:24 ALB

Zoti është i madh dhe i denjë për lëvdimin më të lartë dhe madhështia e tij është e panjohshme. Psalmi 145:3 ALB

Unë lutem që sytë e zemrës suaj të ndriçohen, në mënyrë që të dini se cila është shpresa e thirrjes së Tij, cilat janë pasuritë e lavdisë së trashëgimisë së Tij te shenjtorët dhe cila është madhështia e jashtëzakonshme e fuqisë së Tij ndaj nesh që besojmë. Këto janë në përputhje me veprimin e forcës së fuqisë së Tij që Ai solli në Krishtin, kur e ringjalli nga të vdekurit dhe e uli në të djathtën e Tij në vendet qiellore. Efesianëve 1:18-20 ALB

Rrëfimi—Ki mëshirë për mua, o Perëndi, sipas mirësisë sate; për dhembshurinë e madhe që ke fshiji të ligat që kam bërë. Psalmi 51:1 ALB

Falënderimi—Për dashurinë e fjalës sate dhe simbas zemrës sate ke bërë tërë këto gjëra të mëdha, me qëllim që t'ia bësh të njohur shërbëtorit tënd. Për këtë je i madh, o Zot, o Perëndi. Asnjëri nuk është si ti dhe nuk ka tjetër Perëndi veç teje, me sa kemi dëgjuar me veshët tona. 2 Samuelit 7:21-22 ALB

Ndërmjetësimi:

Fëmijët tanë

Ngrihu _____ i guximshëm në forcën e Zotit dhe shpirti i _____ dhe gjithçka që ajo/ ai është të shpallë madhësinë e Zotit! _____ i tregoftë brezit që do të vijë lëvdimet e Zotit, fuqinë e tij dhe mrekullitë e Tij që Ai ka bërë. (nga Psalmi 138:3, Luka 1:46, Psalmi 78:4b ALB)

Për të Humburit

Se nëse e rrëfeni me gojën tuaj Jezusin si Zot dhe besoni në zemrën tuaj se Perëndia e ringjalli prej së vdekurish, do të shpëtoheni. Romakëve 10:9 ALB

Nxënësit

Megjithatë Zoti i shpëtoi për hir të emrit të tij, për të bërë të njohur fuqinë e tij. Psalmi 106:8 ALB

Mësuesit

Nga ti vijnë pasuria dhe lavdia; ti sundon mbi gjithçka; në dorën tënde janë forca dhe fuqia, dhe ti ke fuqinë për të bërë të madh dhe për t'u dhënë forcë të gjithëve. 1 Kronikave 29:12 ALB

Shkolla

Kështu do të lartësohem dhe do të shenjtërohem dhe do të bëhem i njohur në sytë e shumë kombeve, dhe do të pranojnë se unë jam Zoti. Ezeieli 38:23 ALB

Nënat në lutje

Zoti është i mirë me të gjithë dhe plot dhemshuri për të gjitha veprat e tij. Tërë veprat e tua do të të kremtojnë, o Zot, dhe shenjtorët e tu do të të bekojnë. Ata do të flasin për lavdinë e mbretërisë sate dhe do të tregojnë për fuqinë tënde, për t'u bërë të njohura bijve të njerëzve mrekullitë e tua dhe shkëlqimin e madhërisë të mbretërisë sate. Psalmi 145:9-12 ESV



Organizata Ndërkombëtare Nënat në Lutje